



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 28 shkurt 2020, në mbledhjen e XXII-të (njëzet e dy), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr.52, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 10;10

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, *(me përjashtim të dy anëtarëve, Floretë Zejnullahu dhe Fitim Haziri të cilët janë zgjedhë Deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës).*

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, Durim Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit – DI, Vezir Januzi, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZHR, Mirsad Kamerolli, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, dhe përfaqësuesja e OSBE-së znj.Shkëndiza Kllokoqi.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje, shtoi, besoj që thirrjen dhe materialet për këtë mbledhje i keni marrë me kohë të gjithë andaj mund të vazhdojmë me punë.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, kemi një shkresë/kërkesë të Këshillit të Bashkësisë Islame – KBI në Podujevë e cila është bërë ndërkohë meqë janë bërë disa ndryshime në atë Këshill, përkatësisht është ndërruar kryetari i KBI-Podujevë, prandaj kërkoj që të përfshihet në rend të ditës zëvendësimi i përfaqësuesit të KBI-Podujevë në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Kuptohet se ky përfaqësim është i rregulluar sipas detyrës zyrtare dhe sipas pozitës përkatëse me automatizëm.
(iu shpërndahet të gjithë pjesëmarrësve shkresa e KBI-Podujevë).

znj.Adelinë Stublla, theksoi, kërkoj sqarim rreth zëvendësimit të ish këshilltarit të Kuvendit dhe anëtarit të KPF-së z.Fitim Haziri i cili tani është Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit, sqarim parafolëses, sigurisht keni vërejtur se në thirrjen e mbledhjes së Kuvendit është edhe dhënia e betimit të këshilltarëve të zëvendësuar. Pastaj sa i përket zëvendësimeve në KPF, gjithashtu ju sqaroj se nëse fillohet me zëvendësime në KPF, do të jemi të detyruar të vendosim sipas rregullave të reja të nxjerra në vitin 2019 sipas të cilave duhet të përfshihen të gjitha subjektet e përfaqësuara në Kuvend.

Njëzëri miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës, përfshirë edhe pikën shtesë e cila hynë sipas radhës në pikën 4, dhe atë;

- **Propozimi për zëvendësimin e anëtarit nga radhët e Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB**

1. Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtura më: 28 tetor 2019; 20 nëntor 2019; 03 dhjetor 2019; 26 dhjetor 2019 dhe 29 janar 2020

Njëzëri, në pako, miratohen Ekstraktet e procesverbaleve të cekura në këtë pikë të rendit të ditës.

2. Informatë për punët dhe aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, gjatë vitit 2019

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, në cilësinë e koordinatorit të KKSB në Komunën e Podujevës, e paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera shtoi, ka qenë e planifikuar që kjo informatë të jepej në muajin mars por meqë kishim edhe planin e punës në këtë mbledhje dhe që ndërlidhen mes vete e kemi parë të arsyeshme që për këtë mbledhje të jetë në rend të ditës.

Në këtë informatë kemi punuar një grup punues ku fillimisht kemi marrë të gjitha procesverbalet, pastaj jemi munduar që statistikën dhe mendimet, qëndrimet dhe vendimet kryesore t'i paraqesim në këtë informatë në mënyrë që Kuvendi të ketë njohuri sepse këto nuk mund të ndryshohen por leximi i tyre ju mundëson juve të keni një qasje për çështjet, problemet që është marrë KKSB ku janë statistika të policisë, statistika të Drejtorive të ndryshme e të tjera. Kjo informatë ka kaluar në KKSB andaj një gjë e tillë kërkohet edhe në Kuvend të debatohet në mënyrë që të jepen sugjerime apo edhe vërejtje eventuale, megjithatë është informatë e punës së KKSB-së për vitin 2019 për të cilën ne kemi qenë shumë real sa i përket informacioneve që Kuvend të jetë mirë i informuar.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së i rekomandojmë Kuvendit për diskutim ngase informatat nuk votohen por vetëm mund të diskutohen dhe të jepen rekomandime për të ardhmen apo diçka të tillë.

z.Mehmet Gashi, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së nuk kemi diçka rreth kësaj informate por e mbështesim që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

znj.Adelinë Stublla, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, i rekomandojmë që kjo pikë e rendit të ditës të diskutohet në Kuvend.

U konstatua se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

3. Plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB për vitin 2020

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, në cilësinë e koordinatorit të KKSB në Komunën e Podujevës, e paraqiti propozimin Planin e punës së KKSB-së për vitin 2020, ndër të tjera theksoi, ndoshta ka 3-4 vite që kemi një model plan të punës së KKSB i cili përmban çështje dhe tema të ndryshme të cilat parashihen të trajtohen në mbledhjet e KKSB-së. Ndoshta ka tema të cilat përsëriten por vet natyra e këtij Këshilli ka të bëjë me tema pothuajse të ngjashme dhe të përgjithësuara, por që ashtu siç keni vërejtur në informatë ka tema të cilat janë shumë të zgjeruara brenda një teme. Në vitin e kaluar kemi realizuar planin në tërësi prandaj në këtë vit këtë propozim Plan e kemi analizuar bukur gjatë deri sa është sjellë në KKSB e pastaj edhe në Kuvend. Nuk do të thotë që ky propozim Plan është i përkryer, por edhe përkundër propozimeve tona, presim edhe nga këshilltarët e Kuvendit ndonjë pikë/temë që mund të përfshihet në kuadër të planit ngase fundja këtë propozim Ju jeni ata që e miratoni.

Përvoja jonë sa i përket KKSB-së na ka ndihmuar ta kemi një plan shumë të precizuar dhe i cili në vete ngërthen problemet me të cilat merret ky Këshill. Pastaj ne kemi pas edhe takime me disa Komuna tjera duke i analizuar plane të tilla në 7-8 Komuna e që mund të them se ka Komuna të cilat planet e tilla i

përgatitën shumë të zgjeruara ndoshta me 10-15 faqe, por kur i shikojmë në detaje dalin të jenë punë të Drejtorive duke u marr me trajtimin e projekteve të ndryshëm si në urbanizëm, bujqësi etj, por që natyrisht tema të tilla janë jashtë natyrës së Këshillit, por jo që mund të jenë të Drejtorive.

Keni vërejtur se informata të Policisë çdo herë janë temë dominante në mbledhjet e KKSB-së, pastaj parashihet edhe informatë nga KFOR për sigurinë në territorin e Komunës, i cili çdo herë merr pjesë por që informatat e tyre janë shumë të shkurtra me përjashtim të ndonjë gjendje e cila mund të cilësohet diçka më e rëndësishme. Mandej kemi edhe informatën nga Forca e Sigurisë së Kosovës nga e cila edhe është edhe përfaqësuesi i tyre anëtar i KKSB-së por që informatat e tyre janë vetëm për ndonjë aktivitet të tyre brenda Komunës. Gjithashtu kemi edhe pika tjera të rëndësishme siç është informata për sigurinë në shkollë që bëhet dy herë brenda vitit nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe Komandanti i Stacionit të Policisë, tema këto të cilat kanë qenë shumë të debatuar në KKSB gjatë viteve të kaluara sepse vetë interesimi është i tillë dhe se kohë pas kohe paraqiten probleme në hapësirat jashtë procesit mësimor.

Kemi të paraparë edhe informatën rreth zbatimit të planit operativ për 2019-2020 sipas Strategjisë për parandalimin e ekstremizmit, plan i cili përgatitet nga DKA, Policia dhe Bashkësia Islame.

Është planifikuar edhe sensibilizimi i qytetarëve dhe masa parandaluese për vetëdisimin e qytetarëve rreth pasojave nga zjarri në periudhën e korrje shirjeve e që nuk do të thotë se do të debatohen vetëm njëherë në vit, pjesë e kësaj janë Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Shërbimi i Zjarrfikjes, Policia, Agjencionet e të tjerë që kanë të bëjnë me këtë temë e që për fat të keq numri i zjarreve në Komunën tonë është i madh me një mesatare rreth 700 intervenime. Po ashtu parashihen informata nga Shërbimi i Zjarrfikjes për çdo rast ku bëhen raporte mujore dhe iu ofrohen çdo herë anëtarëve të Këshillit. Pastaj kemi edhe tema rreth projekteve që zakonisht bëhen në muajin qershor fazë kjo e cila edhe nga Ekzekutivi i Komunës bëhen përgatitjet për projektet për vitin pasues e që edhe anëtarët e Këshillit kanë të drejtë të diskutojnë dhe të japin propozime rreth projekteve të nevojshme që ndikojnë në aspektin e rritjes së sigurisë. Parashihet edhe informata rreth gjendjes së pyjeve nga ana e Drejtorisë përkatëse. Është paraparë edhe informata rreth dukurive negative dhe masat senzibilizuese temë kjo e cila është bukur e gjerë sepse ka të bëjë me përdorimin e narkotikëve, dhuna në familje e cila ka qenë shumë e theksuar e për të cilën kemi menduar ta kemi ndoshta edhe temë të veçantë edhe përkundër masave senzibilizuese ngase ndodhin këto si probleme familjare, sociale, mospajtime të ndryshme përfshirë edhe pronën dhe ndoshta deri tek rrahjet mes bashkëshortëve, etj. Përshihet edhe informata për komunikacion nga akterët relevant, pastaj kemi edhe temën rreth riintegritetit dhe procesit të kthimit për personat që kanë pronat e tyre për të cilën jepet informatë nga zyrtari përkatës për kthim.

Pra këto që u cekën jam ndër temat kryesore që do të trajtohen në KKSB kurse tjerat janë tema procedurale, mirëpo nëse ju vlerësoni se ndonjë temë e veçantë jashtë atyre të përgjithshme që janë mund të përfshihet në këtë plan të punës ne e mirëpresim dhe mund ta inkorporojmë në këtë dokument.

z.Mehmet Gashi, theksoi, e përcjella me vëmendje parafolësin i cili është koordinator i KKSB-së dhe mendoj se temat e parapara në planin e punës për vitin 2020 janë mjaft të rëndësishme, mirëpo nëse në mbledhjen e Kuvendit ka ndonjë temë tjetër të rëndësishme e cila mund të përfshihet në planin e punës së KKSB-së nuk paraqet ndonjë problem dhe mund të futet, andaj në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së e përkrahi dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e mbështesim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim kurse të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet tona do t'i japim në mbledhjen e Kuvendit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe ne në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së e mbështesim që t'i rekomandohet Kuvendit.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, mendoj se në propozim planin e punës së KKSB-së për vitin 2020 janë 3 pika të cilat paraqesin shqetësim në Komunën tonë dhe të cilat kanë ngjitje.

Njëra veç u përmend dhe bëhet fjalë për dhunën në familje për të cilën ka një shkallë të ngritjes së kësaj dukurie andaj është e nevojshme që të ndërmerren gjitha masat qoftë nga niveli qendror qoftë lokal që kjo dukuri të trajtohet më me theks.

Qentë endacak po ashtu paraqesin shqetësim tek qytetarët, andaj të merret parasysh edhe kjo çështje edhe pse jemi në dijeni se kjo dukuri i përket edhe nivelit qendrorë, por që ankesat janë nga qytetarët e Komunës së Podujevës.

Pastaj siguri në komunikacion, jemi në dijeni se në 2-3 vitet e fundit siguri në komunikacion nuk është në nivelin e dëshiruar ku po ka fatkeqësi në komunikacion edhe përkundër masave të ndërmarra nga organet kompetente me gjoba, dënime dhe masa tjera për vetëdijesimin e qytetarëve dhe ngasësve të veturave, por megjithatë kërkesa është që të punohet më shumë në këtë drejtim në mënyrë që siguri në trafik të rritet sa më shumë të jetë e mundur dhe të ndërmerren sa më shumë masa parandaluese sa i përket aksidenteve në komunikacion.

Lidhur më këto tema apo dukuri kam vërejtur statistika të cilat vërtetë tregojnë një rritje të numrit të tyre andaj do të ishte mirë të ndërmerreshin masa dhe veprime konkrete parandaluese në kuadër të kompetencave të KKS-së.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, në cilësinë e koordinatorit të KKS në Komunën e Podujevës, theksoi, sa për sqarim, rreth problemit nga qentë endacakë disa herë e kemi pas si temë të veçantë dhe është diskutuar mjaft shumë si problematikë, mirëpo në ndërkohë Qeveria e Republikës së Kosovës së bashku me Agjencionin e Ushqimit dhe Veterinës e kanë marrë në trajtim këtë problematikë e cila është në tërë Kosovën. Kanë filluar të ndërtojnë një strehimore në fshatin Buricë dhe besoj se shumë shpejt do ta funksionalizojnë si dhe të ndajnë fonde në mënyrë që qentë endacak të largohen nga qyteti dhe që trajtimi i tyre të bëhet në mënyrë të kontrolluar në atë strehimore.

Jeni në dijeni se Ligji për mbrojtjen e kafshëve është bukur rigoroz në aspektin e mbrojtjes së tyre dhe ndoshta në këtë kontekst mund të themi se si Kosovë e kemi humbur hapin andaj dhe mund të shohim qen endacak nëpër qytete me theks në hapësirat e QKMF-së pastaj në hapësira të shkollave etj.

Si do qoftë shpresojmë që për këtë problematikë shumë shpejt Qeveria e Kosovës dhe ne si Komunë do ta zgjidhim meqë siç e theksova strehimorja veç është në fazën përfundimtare duke u rregulluar ku sigurisht do të ketë edhe masa tjera rreth trajtimit, eliminimit të tyre ashtu siç rekomandohet me sa më pak dhimbje, masa këto me të cilat merren bukur shumë Organizata të ndryshme të cilat për fat të keq vetëm janë përfituese të donacioneve për projekte të ndryshme dhe rezultati i tyre nuk është i mirë por vetëm merren me kritika, protesta dhe gjëra të ngjashme, kurse asnjëherë nuk dalin dhe të merren me këtë problematikë apo edhe për sigurinë e qytetarëve, nxënësve etj. nga qentë endacak.

Megjithatë shpresoj që Qeveria e Kosovës do të ndaj një fond për funksionalizimin e këtyre strehimoreve për trajtimin e qenve endacak, pa përjashtuar edhe ndihmën nga ana e Komunës edhe pse ne nuk mund të dalim jashtë kompetencave dhe përgjegjësi tona.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, meqë u hap kjo temë unë mendoj se ligji e rregullon çështjen e trajtimit të qenve endacak dhe në këtë fushë patjetër Komuna duhet të ndërlidhet me Agjencionin e Ushqimit dhe Veterinës, madje ndoshta do të duhet të shikohen format e ndarjes së buxhetit nga ana e Komunës për trajtimin e tyre apo të paktën për kastrimin e tyre me qëllim të mos lejimit të shtimit të tyre, kurse për formën e izolimit të tyre mendoj se është në përgjegjësi të Agjencisë. Eliminimi fizik i tyre është ndaluar me të drejtë sepse nuk është formë e duhur dhe është shqetësuese sepse të dilet nëpër lagje me pushkë gjuetie dhe të vriten qen vërtetë është shqetësuese prandaj edhe është ndaluar sepse nuk është e lejuar për arsye të ndryshme.

Sa i përket planit të punës, janë elemente të cilat mund të themi se nuk janë nacionale sepse preken vetëm disa qytetarë siç janë narkomania shembull, pastaj dhuna në familje për të cilën mendoj se si institucione nuk kemi shumë çfarë të bëjmë sepse nuk mund të hyhet si kujdestar nëpër shtëpi dhe të

qëndrojnë institucionet se çfarë bëjnë bashkëshortët mes vete, pastaj fëmijë prindër etj, ngase në çdo moment mund të ndodh një dhunë në familje si shkak i tendencave të ndryshme andaj nuk mendoj se si pikë mund të fokusohemi shumë se do ta rregullojmë këtë në çdo familje, kurse duhet të bëjmë maksimumin që sa më shumë të merremi me parandalimin e kësaj dukurie.

Pastaj duhet të bëjmë shumë për rrezikun në trafik, shembull, nëse në akset përkatëse rrugore vazhdimisht ka pasur aksidente dhe fatalitete dhe nëse Komandanti i Policisë ka qenë i njëjtë atëherë mund të thuhet se është mos efikasitet dhe mos fleksibilitet i tij si përgjegjës për të marrë masa shtesë, qoftë me patrullime, qoftë me radar qoftë forma tjera. Të gjithë jemi në dijeni se fusha e sigurisë është paksa specifike por duhet të ndërmerren masa për zvogëlim sepse eliminimin e tërësishëm nuk mund ta bëjmë dhe kjo gjë dihet, pastaj nëse Komandanti i Stacionit të Policisë vazhdimisht shkon tek Kryetari i Komunës dhe i KKSB-së në këtë rast, me raporte ku në një apo disa akse rrugore në dy-tri vitet e fundit shkaktohen shumë aksidente atëherë vetë Kryetari i Komunës dhe KKSB-së duhet të ndërmerr veprime. Pastaj në rast se kemi shtim të numrit të personave që sillen rreth shkollave dhe kemi identifikim të narkomanëve apo atyre që shesin substanca narkotike nëpër shkolla, ka forma sipas të cilave mund të eliminohen ato dukuri, apo edhe ndaj kiosqeve në afërsi të shkollave të cilat mund të shesin substanca të tilla, e them këtë ngase kam parë disa kioske të cilat shesin cigare me copë e që len dyshime për shitjen edhe të substancave tjera narkotike, kështu që në këtë drejtim duhet të merret një vendim nga Drejtoria e Arsimit dhe Drejtorisë së Inspeksionit që në perimetrin e caktuar në afërsi të shkollave nuk do të lejohet veprimtaria e kiosqeve apo të bëhen kontrole të produkteve në brendësi të atyre kiosqeve apo edhe atyre në brendi të shkollave.

Sa i përket Bashkësisë Islame mendoj që e ka luftuar tendencën e luftimit të formave të këqija të besimit dhe formave tjera të ekstremizmit dhe njëkohësisht e ka ruajtura besimin tradicional dhe për këtë jemi të kënaqur për punën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë sepse ka qenë gjithëherë e kujdesshme në këtë aspekt dhe është sukses për Komunën e Podujevës e cila është tolerante ndaj të gjitha besimeve dhe për menaxhimin e mirë të kësaj problematike, ashtu siç ju jemi mirënjohës edhe institucioneve tjera përkatëse duke përfshirë edhe KFOR-in etj.

Kështu që është mirë që të gjithë, pa dallime politike dhe partiake, në fushën e sigurisë të kontribuojmë në forma dhe aspekte të ndryshme duke i dhënë mbështetje edhe KKSB-së, madje ndoshta në ndonjë dukuri e cila vërehet se ka rritje do të ishte mirë të organizohej edhe ndonjë tryezë e gjerë e KKSB-së bashkërisht me akterë të ndryshëm në fusha të ndryshme përkatëse si, profesorë, persona nga fusha e besimit, ekspert për siguri dhe rend publik dhe fusha tjera përkatëse që ndërliken me aspektin e sigurisë në përgjithësi.

z.Avni Fetahu, theksoi, kujtoj që pata dhënë sugjerime konkrete lidhur me planin e punës së KKSB-së, kam lexuar dhe kam parë se disa prej tyre janë përfshirë në këtë propozim plan por që ka pas hapësirë edhe për të tjerat të cilat besoj se do t'i diskutojmë në seancën e Kuvendit. Është me rëndësi të potencohet tek siguria prej qenve endacak, duhet të jemi praktik në jetë dhe të analizojmë situatën, përse shembull, nëpër fshatra nuk është ky rrezik prej qenve endacak n'krahësim me qytetin, e që faktori numër një është bërllogu që na ka kapluar dhe nuk kemi kah të lëvizim prej tij, shkoni gjejeni një Komunë të caktuar e cila është e pastër dhe sigurisht që nuk mund të gjeni qen endacak sepse nuk ka bërlllog, kështu që kjo është pasojë e mbeturinave që na kanë mbuluar dhe kah janë të theksuara ato ju jeni në dijeni mirë që qentë endacak sillen andej vërdallë dhe në mbeturina, kështu që nuk duhet të hidhet faji në vazhdimësi duke thënë që është përgjegjësi e kësaj apo asaj, por duhet edhe praktikisht edhe në qoftë se nuk është fare përgjegjësi e Komunës duhet të mendohet çka mund të bëhet. Andaj nëse do të eliminohej kjo pjesë e bërllogut të paktën do të kishte më pak qen endacak dhe siguri do të ishte më mirë.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Propozimi për zëvendësimin e anëtarit nga radhët e Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për zëvendësimin e anëtarit në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB, përkatësisht z.Mensur Hoti, Kryetar i Bashkësisë Islame në Podujevë, zëvendëson z.Osmon Kurtollin, ish Kryetar i Bashkësisë Islame në Podujevë dhe anëtar në KKSB – Podujevë.

Mbledhja përfundoi në orën 10;40

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0021853/20

Podujevë,

28 shkurt 2020

Kryesuesi i Komitetit

Fatmir Gashi